


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8 Sh-1  
492



Rinore

*poetri*


Bashkim Hoxha

856 - 1  
H92

BASHKIM HOXHA

# Rinore

poezi



12628

12628

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## R R I T J E

Askush s'do dont'e tē ngelej tērē jetēn  
një fëmijë i vogël që e mëkojnë,  
ndryshe ç'kuptim do tē kishte shtati që na rritet  
dhe kraharori që zgjerohet?

Ndaj ndër aksione rendëm,  
në hekurudha,  
rrugë  
e kantiere,  
shtegëtim i bukur i rritjes sonë  
ku ne pohonim vetveten.

Sendeve nuk u mësuam vetëm nocionin  
mbi katedra, nëpër faqe librash.  
Me hap horizontet i përshkuam  
mes për mes stacioneve tē ditëve...

Duke punuar mësuam ç'do të thotë punë,  
duke u përleshur mësuam ç'do të thotë luftë  
klase.

Dhe e dimë mirë se buka nuk del nga furra,  
ajo nxirret nga balta . . .

## LUFTA E BREZIT TIM ME BORGJEZINË

Ne nuk e njohëm pronën private,  
as kambialet, pasuritë e palëvizshme,  
dyqanet private grumbulluar në faqet e shesheve  
si puçrra të bezdissishme.

Po ne mësuam se dhe një kufomë  
mund ta infektojë gjakun fare mirë,  
ndaj e luftojmë borgjezinë çdo çast, çdo orë  
me vigjilencë e me guxim.

Dhe nuk lëmë mjekër e flokë të gjatë,  
pyjeve nuk bredhim për të protestuar,  
ne dalim në sheshin e luftës me grushtin proletar  
drejt e nënofull për të qëlluar.

Përbaltemi për bukën, rendim në aksione  
dhe veshim rrrobën e gjelbër të ushtrisë,  
me fletërrufetë që përflakin sheshet,  
patericën e fundit i heqim borgjezisë.

## KËRKESË PËR JETËN

Ç'kuptim do të kishte  
të qëndroja shtrirë tërë ditën  
e mendimet boshe,  
si re karkalecash,  
të uleshin në brazdat e trurit tim,  
të dremisja i plogësht pranë zjarrit  
duke ëndërruar si diçka abstrakte lumturinë?

Unë lëviz tërë ditën në mes njerëzve,  
marr frymë bashkë me ta,  
gjallërohem nga frymëmarrja e përbashkët,  
përpjek kilometra jete pa mbarim,  
kilometra që rëndojnë nga ngjarjet.

Dhe ndodh tërë natën rri zgjuar mbi letra,  
tëmhat gjer në dhembje i shtrëngoj,  
atëherë unë shijoj një lumturi konkrete  
dhe nga pantoflat e Obllomovit distancën zgjatoj...

## 20 V J E Ç

Nata është e qetë, nata është e butë.  
Qetësia është shtrirë gjatë e gjerë  
në të gjitha rrugët.

Digjen llambat  
si i vetmi mendim  
në një tru të qetë,  
që fle.  
Po si mundesh, vallë,  
njëzetvjeçar  
i qetë të jesh sa s'ka më?!

Në trurin tim kalon plugu i kohës  
dhe rriten èndërrat si fije bari,  
si kallinj gruri piqen mendimet...

Si mundesh, vallë, të jesh i qetë  
kur ndien të rritet jeta me kërcitje?

Ditën që mbush njëzet vjet  
je si bujku në ditët e para të pranverës.

## DITË TË NGROHTA

Çdo njeri ka ëndërra të bukura  
që kërkojnë të ngjiten në lartësi,  
socializmi është qelli i madh i kaltër  
ku ato marrin fluturim.

Dëshirat e fuqishme çdo njeri  
me dashurinë e vet përditë i ushqen,  
socializmi është stina më e ngrohtë  
ku gjelbërimi i zemrës zë shpërthen.

## NËNA E DËSHMORIT

C'kërkonte mbrëmë nëna e dëshmorit,  
ç'kërkonte mbrëmë në sytë e mi?  
Ajo më përqafonte dhe heshtte  
pa më thënë se i ngjaja të birit.

Ishte nata e parë e pranverës,  
në qìell hëna u shfaq e kuqe;  
unë ndjeva papritur se vetëm për një natë  
mund të mbushen gjithë pemët me lule.

Dhe për një natë mund të ndiesh kaq pranë  
të kaluarën dhe përjetësinë,  
veten më mirë mund ta kuptosh,  
ç'kërkohet prej teje mund ta kuptosh më mirë.